

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Protesa kundër vendimit dënues të Speciales ndaj ish-krerëve të UÇK-së
ADRESA	https://www.koha.net/arberi/edhe-sot-proteste-kunder-vendimin-denues-te-speciales-ndaj-i-sh-krereve-te-uck-se
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 01:55:09 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 06:04:39 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a400a8ca6e98a9de15047082694d14487b11771c99aef7525f055ae03cfb7055
TEKSTI	b6f82ff4ab8c71e03fb4add3998ea8f63af4d06341e257ddeb81d57a03069107
PAMJA	46903b62a4e3df55590c7842d13f836971de8c99aa20cca1c1f0e9e9315e5691

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8317e937fad0060f096d9ef9315672433e547cf88f84cb607f97a17e5baa1a70
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9820c0ddeb45471f928207a963ca36ba3aaf52dec6ebcd920f8d826671ee6c4b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8317e937fad0060f096d9ef9315672433e547cf88f84cb607f97a17e5baa1a70>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

ARBËRI


Mijëra qytetarë protestojnë kundër vendimit të Speciales ndaj ish-krerëve të UÇK-së

12 o. më parë

Hamza: Protesta s'është e drejtuar ndaj askujt, por në përkrahje të plotë të ish-krerëve të UÇK-së

12 o.

Lima



18 shtator 2026 08:04

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalën tonë zyrtar në Viber

Mijëra qytetarë kanë protestuar në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë, në protestën e thirrur nga Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, për të kundërshtuar vendimin dënues të Speciales ndaj katër ish-udhëheqësve të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Ndër kërkesat e protestuesve ka qenë shfuqizimi ose ndryshimi i Ligjit për Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë, shkarkimi i ministres së Drejtësisë, Donika Gërvalla e mbështetja financiare për mbrojtjen e ish-krerëve të UÇK-së

Hamza: Protesta s'është e drejtuar ndaj askujt, por në përkrahje të plotë të ish-krerëve të UÇK-së

12 o. më parë / 18 sht 2026 13:05



Kryetari i PDK-së, Bedri Hamza në një prononcim për gazetarë gjatë protestës ka thënë se vendimi dënues i Gjykatës Speciale ndaj katër ish krerëve të UÇK-së është i papranueshëm dhe, sipas tij, i pabazuar në fakte.

Hamza tha se kjo protestë nuk është drejtuar ndaj askujt, por është në përkrahje të plotë për Hashim Thaçin, Kadri Veselin,

Kulturë.

"A Chip Odyssey" dekodon frymën e zhvillimit të Tajvanit

Arbëri.

Jashari: Kosova duhet të sillet si e rritur karshi Evropës dhe Amerikës

Arbëri.

Jashari: PDK-ja duhet ta ketë Ministrinë e Drejtësisë

Futboll.

Brentfordi turpëron Chelsea

LAJMET E MBRËMJES.

Bashkëpunëtorë dhe bashkëveprimtarë e kujtojnë kontributin e Flora Brovinës

Futboll.

Bayerni me fitore 7:0, Kane vendos rekord

Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi.

“Ne jemi për drejtësi, jemi kundër padrejtësisë dhe tash këtë proces, këtë gjykatë çka kemi pa, kemi pa padrejtësi. Ky është një vendim i papranueshëm për qytetarët e Kosovës, vendim i padrejtë, i pabazuar në fakte, është vendim politik dhe sigurisht ne jemi këtu me shpreh pakënaqësinë tonë. Kjo protestë është në përkrahje të liderëve tanë, të udhëheqësve të UÇK-së, solidarizim dhe përkrahje e pakufishme për të. Nuk është e drejtuar ndaj askujt, po, në përkrahje të plotë. Do bëjmë gjitha veprimet e nevojshme, demokratike, edhe protesta, por, edhe veprime ligjore. Besoj se sot do të konkretizojmë në Kuvendin e Republikës së Kosovës”, tha Hamza, raporton EO.

Specialja dy ditë më parë i ka dënuar me nga 25 vjet Burgim Thaçin e Krasniqi, me 18 vjet Veselin e me 13 Selimin.

Limaj: Duhet të diskutohet integriteti i gjyqtarëve që gjykuan ish-krerët e UÇK-së

12 o. më parë / 18 sht 2026 12:59



Kreu i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka marrë pjesë në protestën e mbajtur në Prishtinë në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së pas aktgjykimit dënues të Gjykatës Speciale në Hagë.

Limaj tha se një nga çështjet kryesore që duhet të diskutohet është integriteti i gjyqtarëve që marrin vendime në këto procese. Ai tha se gjyqtari që ka udhëhequr trupin gjykues ka zbatuar urdhra politikë.

“Po e shihni sa i rëndësishëm është integriteti personal i një gjyqtari. Një gjyqtar që hapur ka zbatuar urdhra politikë, ka kryesuar trupin gjykues dhe sot ...”, tha Limaj në një deklaram për media gjatë protestës.

Limaj tha se vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet pikëpyetjeve rreth personave që gjykojnë dhe integritetit të tyre.

“Një nga temat kryesore që duhet të diskutohet është pikëpyetja e atyre që gjykojnë, integriteti i atyre që gjykojnë, ndaj një padrejtësie që po bëhet ndaj njerëzve nga njerëz pa integritet. Dhe gjëja e parë që duhet të kërkohet është, kush janë gjyqtarët, integriteti i tyre...”, tha mes tjerash ai./EO

Gucati: Kurti ta përjashtojë nga Qeveria Gërvallën, ka dorëzuar dokumente në Hagë

12 o. më parë / 18 sht 2026 12:46



Photo: Driton Paçarada

Kryetari i OVL-UÇK-së, Hysni Gucati, i ka drejtuar një kërkesë Gjykatës Speciale e një Qeverisë në Kosovë.

Ai ka kërkuar nga gjykata që vendimin dënues ndaj ish-krerëve të UÇK-së ta shfuqizojë, e i ka kërkuar kryeministrit Albin Kurti

që ta shkarkojë ministren e Drejtësisë, Donika Gërvalla.

“Ne sot na befason që ende institucionet nuk e kanë thënë asnjë fjalë. Në vend që Donika Gërvalla të japë një deklaratë për një padrejtësi që është bërë për çlirimtarët, ajo sot hesht. Ne e dimë që Donika Gërvalla ka dorëzuar dokumente në Hagë, ne e dimë që Liburn Aliu ka folur në parlament, i themi Albin Kurtit që këta njerëz t’i përjashtojë nga Qeveria. Njerëz që bashkëpunojnë me armikun, janë armiq të vendit dhe kombit dhe ne nuk i duam në mesin tonë”, ka thënë ai para protestuesve.

Gucati i ka kërkuar edhe Gërvallës kërkimfalje e sqarim Liburn Aliut. Aliu ishte ministër i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, deri në gusht të vitit 2025, kur dha dorëheqje. Aktualisht, ai ushtron pozitën e drejtorit të portit të Durrësit në Shqipëri.

“Më befason Kurti si e mban ende në zyre një njeri që nuk e thotë asnjë fjalë. Gërvalla le të kërkojë falje, kërkojmë sqarim nga Gërvalla dhe Aliu të deklarojnë ku i morën ato informata, kush janë ata që i kanë vlarë ata njerëz. Jo të drejtohet gisht nga pjesëtarët e UÇK-së”.

Mijëra qytetarë protestojnë kundër Speciales

13 o. më parë / 18 sht 2026 11:37



Photo: Driton Paçarada

Mijëra qytetarë janë mbledhur në sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë për protestën e thirrur nga Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së në kundërshtim të vendimit të Gjykatës Speciale për ish-krerët e UÇK-së.

Mes tyre janë edhe deputetë dhe figura publike.

Djali i Jakup Krasniqit, Altin Krasniqi, u ka bërë thirrje partive politike e shoqërisë për bashkim, duke thënë se mbrojtja e luftës së UÇK-së dhe vlerave të saj është luftë e përbashkët.

“Ajo që ndodhi në Hagë nuk mund ta shohim vetëm si çështje ndaj katër individëve... Për gjashtë vjet kemi kërkuar drejtësi sepse kemi besuar se drejtësia do të triumfojë përmes fakteve, provave dhe një procesi të drejtë. Ne do të vazhdojmë të kërkojmë drejtësi, por drejtësia duhet të jetë e njëjtë për të gjithë, provat duhet të shqyrtohen me paanshmëri, dëshmitë duhet të vlerësohen me drejtësi dhe askush nuk duhet të dënohet mbi bazat e provave të fabrikuara e manipuluar”, ka deklaruar ai.

Gjykata Speciale me seli në Hagë ka dënuar Hashim Thaçin dhe Jakup Krasniqin me nga 25 vjet burgim, Kadri Veselin me 18 vjet dhe Rexhep Selimin me 13 vjet burgim. Të gjithë janë dënuar për krime lufte, ndërsa janë shpallur të pafajshëm për krime kundër njerëzimit.



Foto: Driton Paçarada



Foto: Driton Paçarada



Foto: Driton Paçarada



Foto: Driton Paçarada





Ambasada amerikane i bën thirrje stafit të vet: Shmangni sheshin “Skënderbeu”

14 o. më parë / 18 sht 2026 10:52



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.